



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEQA"

FINANCAT E KORPORATAVE

SISTEMI FINANCIAR DHE INSTITUCIONET FINANCIARE

Kapitulli 2

MSc. Fisnik Morina, PhD (c)

TETOR 2017

SISTMI FINANCIAR DHE EKONOMIA

- ✓ Ky seksion diskuton funksionet kryesore të ndermjetesve financiar dhe tregjeve financiare, të cilat bëjnë transferin e fondeve nga ata që kanë tepër te fondeve tek ata që kanë mungesë të tyre.
- ✓ Ndermjetesuesit financiar dhe tregjet financiare kryejnë dy funksione themelore të shërbimeve financiare:
 - Bëjnë reduktimin e kostove të levizjes së fondeve mes huadhenesve dhe huamarresve,
 - Duke çuar në një shpërndarje më të efektshme të burimeve dhe rritje më të shpejtë ekonomike.



SISTEMI FINANCIAR

Sistemi financiar i një vendi nënkupton një sërë marrëveshjeve financiare me të cilën kursimet në ekonomi janë të mobilizuara për investime dhe në asete produktive.

Furnizuesit dhe përdoruesit e mjeteve janë një pjesë e sistemit financiar.


Kështu, sistemi financiar është i shqetësuar me huamarrjen dhe huadhënien e fondeve ose të kërkesës dhe ofertës së fondeve të të gjithë individëve, institucioneve, shoqërive dhe Qeverisë.



SISTEMI FINANCIAR


Një sistem efikas financiar:


- a. Inkurajon kursimet,
- b. Rrjedha e kursimeve për përdoruesit është me e efektshme,
- c. Zbaton politikën monetare të qeverive duke ndikuar ne normat e interesit,
- d. Kombinimi i aktiveve dhe detyrimeve që përbëjnë atributet e dëshiruara, kthimit të rrezikut të likuiditetit, si dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare.



Ekzistojne tre grupe potenciale te kursimtareve dhe huammarresve ne ekonomi:

1. Familjet,
2. Bizneset, dhe
3. Qeverite.

- 
- Individët janë të bashkuar në familje. Familja është një bashkësi njerëzish që bëjnë jetë të përbashkët dhe marrin vendime të përbashkëta ekonomike dhe financiare. Anëtarët e familjes quhen ndryshe edhe konsumatorë.
 - Firma në biznes përfaqëson njësinë bazë që përdor faktorët e prodhimit për të prodhuar mallra dhe shërbime që i shet te firmat e tjera, familjet ose qeveritë. Për këtë arsye firma me të drejtë quhet ndryshe edhe prodhues.

- 
- Termi qeveri përdoret në teorinë ekonomike në një kuptim të gjerë dhe përfshinë nëpunësit publikë, agjencitë, organet qeveritare dhe organizmat e tjera që janë nën kontrollin direkt të qeverisë.
 - Ideja themelore e kuptimit të termit qeveri është se të gjitha organizmat dhe agjencitë që përfshihen në qeveri, kanë fuqi politike e ligjore për të ushtruar kontroll mbi agjentët ekonomikë individual dhe mbi tregjet.



Sistemi financiar siguron tre sherbime kryesore:

1. Ndarjen e rrezikut,
2. Likuiditetin, dhe
3. Informimin.



- **Ndarja e Rrezikut**

- Rreziku paraqet shkallen e pasigurise per kthimin e mjeteve.
- Sistemi financiar permes institucioneve financiare dhe tregjeve financiare e bene ndarjen e rrezikut ose transferimin nga ata qe ndernarrin investime per ata qe japin fonde per investime.



❖ 2. Likuiditeti

- ❖ Sigurimi i likuiditetit dhe performances ekonomike lind, sepse shume projekte investive afatgjata me kthime te larta kerkojne angazhime afatgjata te kapitalit, mirepo huadhenesit (kursimtaret) ne kete menyre e delegojne nje rrisk te padeshiruar.
- ❖ Dhe ne pergjithesi ata jane te gatshem qe te kene kontrollin mbi kursimet e tyre kur behet fjale per investime afatgjata.



✓ 3. Informimi

- ✓ Sistemi financiar mund te zvogeloje kostot e informacionit mes huamarresve dhe huadhenesve.
- ✓ Tregjet financiare perpunojne informacionet per secilen firme te listuar ne burse. Ne keto tregje informacionet mblidhen dhe shperndahen permes cmimeve.



TREGJET FINANCIARE

Ne literaturen ekonomike hasim disa definicione per tregjet financiare, p.sh.,

``vend ku tregtohet me forma te ndryshme te aktivitet financiar``

``vend i organizuar ne te cilin takohet oferta dhe kerkesa per forma te ndryshme te instrumenteve financiare``

``nje treg shume konkurrues i instrumenteve financiare te cilat paraqesin nje seri te drejtave te kontraktuara``



- 
- Ne Aktiv financiar i perfshijme te gjitha format e mundshme te instrumenteve financiare, te cilat jane objekt tregtimi ne trgjet financiare si: paraja, devizat, letrat me vlere qeveritare dhe jo-qeveritare, metalet e cmueshme, kontratat fjucers, opcionet etj.
 - Me Instrumente financiare kuptojme te gjitha kerkesat e tregtueshme (te kembyeshme) pa veshtiresi.

Figure 1.1 Financial markets and flow of funds relationships





Dimenzionet e Tregut Financiar

1. Tregu i Parave,
2. Tregu i Kapitalit,
3. Tregu Devizor, dhe
4. Tregu i Derivateve Financiare.



Tregu i Parase

- Tregu i Parase paraqet vendin ku takohet oferta dhe kerkesa per instrumente te borxhit afatshkurter.
- Ky treg ka rendesi te jashtezakonshme ne secilen ekonomi kombetare sepse permes tij krijohet norma afatshkurter e kamates, e cila eshte indikator i besueshem i cmimit te parase, i cmimit te kreditit dhe atij te kapitalit.
- Segmentet e ketij tregu jane: Tregu i xhiroparase dhe Tregu i letrave me vlere afatshkurtera.
- Aktiviet financiare qe tregtohen ne kete treg jane: bonot e thesarit, letrat komerciale, akceptet bankare, obligacionet afatshkurtera etj.,.



Tregu i Kapitalit

- Tregu Kapitalit paraqet vendin ku takohen oferta dhe kerkesa per aksione dhe obligacione me afate te gjate te maturimit.
- Ky treg i ushtron dy funksione: ne tregun primar dhe ne ate sekondar.



Tregu Devizor

- Tregu Devizor definohet si segment i tregut financiar ne te cilin tregtohet me deviza, qe nenkupton tregtimin me te gjitha kerkesat – detyrimet e arketueshme, nga huamarresit dhe investitoret, te denominuara ne valuta te jashtme.




Tregu i Derivateve Financiare

- Perveq tregjeve ku tregtohet me mallra dhe me letra me vlere, ekzistojne tregjet ku nuk kembehen mallrat apo letrat me vlere, por tregtohen instrumentet e ``derivuara`` ne baze te ketyre mallrave dhe sherbimeve. Keshtu ekzistojne tregjet e fjucersave dhe opcioneve.
- Keto tregje kane lindur si rezultat i pasigurise qe mbreteron lidhur me cmimet e ardhshme te mallrave dhe te letrave me vlere.



Institucionet Financiare

- Institucionet financiare jane institucione qe marrin pjese ne tregjet financiare ne krijimin ose shkembimin e aktiveve financiare.
- Ato lidhen me huamarresit jo ne menyre direkte permes tregjeve kapitale por ne menyre indirekte permes ndermjetesuesve financiar.





Institucionet Financiare

- ❑ Institucionet financiare shërbejnë si ndërmjetësues duke kanalizuar kursimet e individëve, bizneseve dhe qeverive në kredi për investimeve.
- ❑ Ato janë një burim kryesor i fondeve për individët, bizneset dhe qeverite.

INSTITUCIONET E TREGUT TË LETRAVE ME VLERË

- Janë të gjitha ato institucione të cilat e mundësojnë transferimin e letrave nga një pronarë të tjetri.
- Letrat me vlerë shkëmbehen në tregun primar dhe sekondar.
- Akterët në tregun e letrave me vlerë janë:
 - ✓ **Banka investuese:** ndihmon dhe këshillon në emetimin e letrave me vlerë
 - ✓ **Firmat komisionare dhe tregtare** ndihmojnë tregtimin e letrave në tregun sekondar.
 - ✓ **Shoqëritë e përlogaritjeve dhe barazimit (clearing house)** kujdesen që detyrimet që I marrin palët të kryhen.
 - ✓ **Bursat e letrave me vlerë (Stock exchange)** është shtëpia ku takohen blerësit dhe shitësit.



BANKAT INVESTUESE

- Bankat e investimit janë institucione financiare të cilat si biznes kryesor e kanë këshilldhënien e shoqërive për emetimin e letrave me vlerë.
- Banka investuese garanton se një pjesë e letrave me vlerë do të shitën në treg çmimin e paracaktuar.
- Nëse nuk arrihet shitja atëherë Banka investuese i blen ato letra me vlerë për portfolion e tyre.



BANKAT INVESTUESE

✓Më derregullimin e tregut bankar, bankat investuese kanë filluar të shtrijnë aktivitetet e tyre edhe në fushat tjera të sistemit financiar.

P.sh. Duke inkuadruar firmat komisionere dhe tregtare dhe funksionin e bankave tjera.

✓Bankat investuese zakonisht e bartin një risk të lart duke u bërë garantues për emetuesit e letrave me vlerë.

ROLI I BANKAVE TË INVESTIMIT NË EMISIONIN PARËSOR

➤ Këshillimi i klientëve

- Ndhmojnë në përcaktimin se si me i rrite fondet për projektet në fjalë.
- Me vlerësimin e projekteve që dëshiron t'i zhvilloje shoqëria nga ana e bankës investuese, palët hynë në marrëdhënie kontraktuale.
- Banka investuese që e nënshkruan kontratën me emetuesin quhet iniciatorë e emisionit të letrave me vlerë “origjinatore”
- Banka investuese krijon dy grupe për ekzekutimin e procesit të emetimit.
 - ✓ Grupi i parë, quhet sindikata nënshkruese të emisionit,
 - ✓ Grupi i dytë, quhet grupi i shitjes së letrave me vlere.



ROLI I BANKAVE TË INVESTIMIT NË EMISIONIN PARËSOR

➤ **Administrimi i emisionit të ri të letrave me vlerë**

- Kjo nënkupton që banka investuese bëhet përfaqësuese e shoqërisë para komisionit të kontrollit të letrave me vlerë.
- D.m.th . Që përgatit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e emetimit.

➤ **Regjistrimi i emisionit të ri të letrave me vlerë**

- Me regjistrimin e emisionit banka investuese fillon procesin e shitjes, dhe garanton për një performancë.

SHITJA E LETRAVE ME VLERË

- Banka investuese shitjen e letrave me vlerë e bënë zakonisht në bashkëpunim me bankat tjera investuese, ku krijohen sindikatat që të shpërndahe risku.
- Format e shitjes janë:
 - **“Best effort”** të provohet të shiten të gjitha letrat me vlerë.
 - **“Stand by” gjendja gatishmërie**, ku banka investuese premtton që do ti blenë të gjitha letrat me vlerë që nuk janë shitur.

FIRMAT KOMISIONERE DHE TREGTARE

- Firmat komisionere dhe tregtare të letrave me vlerë janë të specializuara për të kryer transaksione në tregun sekondar të kapitalit.
- Firmat komisionere:
 - Janë agjentë ekonomik që e kryejnë punën teknike ndërmjet blerësit dhe shitësit të letrave me vlerë.
 - Si pjesë të të hyrave firmat komisionere marrin komisione
 - Firmat komisionere riskun e transferojnë të shitësit dhe blerësit.
 - Të vetmin risk e kanë teknologjinë që e ekzekuton shitë/blerjen.



FIRMAT TREGTARE TË LETRAVE ME VLERË

- Këto firma në emër të vetin kryejnë transaksione në tregun kapitalit.
- Blejnë dhe shesin letra me vlerë për portfolion e tyre.
- Proceset e tilla janë shumë dinamike por këto firma zakonisht janë profesionale dhe tentojnë të minimizojnë riskun.

SHOQËRITË E PËRLLOGARITJEVE DHE BARAZIMIT (CLEARING HOUSE)

- Shoqëritë e barazimit kujdesën që në fund të ditës salldot e transaksioneve të barazohen.
- D.m.th që ndrimi i pronarëve të letrave me vlerë është i madh dhe kjo shoqëri kujdeset që këto transaksione të kryhen me kujdes.
- Ditën e sotme provohet që fare mos të ketë shtypje të letrave me vlerë, sepse informata mbi pronësinë mbahet në formë elektronike në këto shoqëri.



BURSAT E LETRAVE ME VLERË

- Bursat e letrave me vlerë është vendi ku takohen shitësit dhe blerësit.
- Zakonisht këto shtëpi janë shoqëri në mirëbesim (trust). Ku si qëllim e ka shërbimin se ma të mirë për beneficuesit e vet.

- Për tu antaersuar në Bursë firmat duhet ti plotësojnë disa kushte:
 - Madhësia e firmës
 - Vlera e fondeve kapitale neto
 - Vlera e tregut e letrave me vlerë
 - Numri i letrave me vlerë që zotërohen nga popullata
 - Pagesa për tu regjistruar
 - Publikimi I pasqyrave financiare
 - Auditim të jashtëm për pasqyrat financiare
 - Kërkesa tjera specifike sipas bursave konkrete.



➤ Letrat me vlere kembehen ne dy menyra:

1. Permes bursave,
2. Permes OTC tregjeve.

Ne Tregjet OTC, tregtia behet permes telefonit dhe kompjuterit.
Brokeret dhe Dileret i takojne bleresit dhe shitesit.

- Brokeret marrin provizion, duke takuar bleresit dhe shitesit e fundit ne tregun e caktuar.
- Dileret bejne tregti ne favor te vetin. Ata mbajne rezerva te letrave me vlere dhe i shesin ato me cmim me te larte, se sa qe kane paguar per to, duke realizuar fitimin ne mes te cmimit te ofruar dhe cmimit te kerkuar.



Institucionet depozituese dhe Investitoret institucional

- Potencialet financiare I formojne permes grumbullimit te depozitave te kursimit
- Investimin e ketyre potencialeve e bejne ne forme te kredise/huave qe u akrodojne bizneseve dhe individeve
- Ndahen ne keto kategori:
 - Banka komerciale
 - Shoqeri te kursimeve dhe te huase
 - Banka e kursimeve te perbashketa
 - Bashkimet kreditore



Bankat komerciale

- Bankat komerciale, fondet e investimeve I investojne ne forme te kredive dhe huave per biznese dhe individe
- Keto kredi mund te jene afatshkurtra dhe afatgjata per investime ne biznese
- Kredi konsumuese dhe kredi me hipoteke per individe
- Kreditimi afatmesem dhe te gjate te bizneseve bankat komerciale e bejne nga depozitat e kursimit ne te pare dhe te afatizuara
- Ne kushtet e tregut financiar, ne shkalle te ekonomise se nje vendi dhe ate nderkombetare, bankat aplikojne operacione parabankare dhe shitblerjet kolaterale
- Keshtu te ardhurat krijohen nga diferenca ne mes normave te interesit depozitare-kreditore dhe komisionet e operacioneve jashtbilancore



Shoqerite e kursimeve dhe te huase

- Marrin hua fonde nga kursimtaret dhe I kalojne ato tek individet dhe firmat e biznesit qe u nevojiten para kundrejt hipotekes
- Keto llogari jane me likuide ngase mund te terhiqen me lehtesi
- Kane shkalle te larte sigurie, ngase sigurohen nga shteti
- Norma e interesit eshte me e larte
- Potencialet investohen ne forme te kredive per individ, siq jane:
 - Kredite konsumatore
 - Afatshkurta dhe afatgjate te hipotekes per ndertim



Bankat e kursimeve te perbashketa

- Keto jane te ngjashme me shoqerite e kursimeve, por se keto menaxhohen nga nje bord menaxherash te zgjedhur nga pronaret e bankave.
- Keto japin hua te hipotekes dhe blejne letra me vlere me garanci hipoteke.
- Poashtu u nenshtrohen legjislacioneve te shtetit (BQ) e cila rregullone rezervat e detyrueshme dhe likuiditetit per te perballuar terheqjet .
- Aplikon norma me te larta interesi dhe poashtu jane te siguruara nga autoriteti shtetror.



Unionet kreditore

- Unionet kreditore japin hua me norma interesi me te uleta
- Keto ndihmojne sidomos ata huamarres te cilet kerkojne hua te vogla financimi per nevoja aktuale deri ne inkasimin e dividendes interesit etj
- Unionet kreditore themelohen ne baza vullnetare dhe antaret e bashkimit kane te drejte vote varesisht nga shuma e kursimeve te depozituara
- Ekziston kontrate me shkrim per marrveshjet e aktivitetit ne mes bashkesise dhe antareve te saj, ne zonen e operimit
- Antarsimi ne unione kreditore ishte e kufizuar vetem per punonjes, ndersa tani mund te antarsohet cdo njeri qe ka kursime.



Investitoret Institucional

- Investitoret institucional karakterizohen nga menyra e formimit te fondeve financiare dhe menyres se investimit te tyre
- Fondet sigurohen permes formes jodepozitare, ne baze te shitjes/blerjes se kontratave te sigurimit te individeve dhe bizneseve, permes sigurimit personal te tepunesuarve ne shoqerite e medha dhe shitjes se aksioneve qytetarve
- Investimet e ketyre fondeve behen ne forme te investimeve ne letra me vlere, duke krijuar keshtu portofolin optimal, ne te ardhurat e pritura dhe shkalles optimale te likuiditetit
- Kriteret per krijimin e portfolios mirren:
 - Norma e pritur e rendimentit nga obligacionet afatgjate
 - Lartesia e pritur e dividendes nga aksionet
 - Shkalla e likuiditetit e letrave me vlere me afat me te shkurter



Klasifikimi I investitoreve institucional

- Institucionet e kursimeve kontarktuale:
 - Shoqerite e sigurimit
 - Fondet pensionale
- Institucionet ndermjetese te investimit:
 - Shoqerite e investimit (fondet e perbashketa)
 - Shoqerite e financimit
 - Fondet e perbashketa te tregut te parase



Institucionet e kursimeve kontraktuale

- Ketu perfshihen institucionet te cilat sigurijne fondet permes kontratave te sigurimit te jetes, pasurise dhe pensionit
 - Shoqerite e sigurimit- jane institucione finnanciare, qe potencialet e tyre I krijojne permes sigurimeve, shitjes se policave te sigurimit individeve dhe bizneseve
 - Format organizative te institucioneve siguruese varen nga:
 - Lloji I sigurimit qe kryejne
 - Shkalla e riskut

Likuiditetin e ruajne permes shumave te parase ne llogari transaktive si dhe segmentit afatshkurt te portofolios se letrave me vlere

Ato mund te programojne leht potencilaet financiare, ngase varen nga arketimet e kontraktuara



Fondet pensionale

- Kane te bejne me sigurim pensional te te punesuarve ne shoqerite e medha ne baza kolektive
- Forma organizative e fondit pensional varet nga madhesia e fondit te potencialeve financiare dhe numri I te siguruarve
- Edhe keto fonde krijojne rezerva me afat te gjate, prandaj perdoren per investim me afat me te gjate, permes shit/blerjes se letrave me vlere
- Aktiviteti I tyre zhvillohet ne forme kontraktuale dhe mbeshtetet ne te hyra mujore
- Likuiditetin e ruajne permes shumave ne llogari transaktive dhe mbajtjes se nje pjese te letrave me vlere me afat te shkurt

FUNDI I KAPITULLIT TË DYTË

